

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Have Haliti, anetarë, me bashkëpunëtoren profesionale, Syzana Goxhuli si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.B. nga Gjilani për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.59/2018, të datës 31.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10 shtator 2018 mori këtë :

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.B., **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.59/2018 i datës 31.05.2018 sa i përket vendimit mbi sanksionin penal ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit B.B. për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muaj, e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 02.03.2018 deri më datë 30.03.2018, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 100(njëqind) Euro, e të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.59/20182015 të datës 31.05.2018, i akuzuari B.B. është shpallur fajtor për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së, për të cilën është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, në të cilin dënim me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 02.03.2018 deri më 30.03.2018 dhe dënim me gjobë në shumë prej 200(dyqind) Euro.

Nëse i akuzuari nuk ka mundësi ta paguaj gjobën apo refuzon ta paguaj atë, i njeiti dënim me gjobë do t'i shëndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20(njëzet) Euro do t'i llogaritet 1(një) ditë burgu.

Gjithashtu, ndaj të akuzuarit është shqiptuar edhe dënimi plotësues-konfiskimi i substancës narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 8.7 gram.

I akuzuari B.B. është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30(tridhjetë) Euro në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B.-av.A.L. nga Gjilani, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarit për veprën penale të kryer t'i shqiptoj dënim më të ulët më burgim dhe me gjobë, e me të cilat dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me shkresën e vet PPA/I.nr.327/18 të datës 24.07.2018 duke u skjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.B.-av.A.L., ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar i Gjykatës Themelore në Gjilan të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ka marrë pjesë mbrojtësi i të akuzuarit –avokati A.L., ndërsa ka munguar Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, dhe I akuzuari B.B., edhe pse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt andaj seanca është mbajtur në mungesë të tyre, në pajtim me nenin 390 par.4 të KPPRK-es.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se i njejtin nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë e as shkelje të ligjit penal.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe kolegji i Gjykatës së shkallës së parë është pajtuar me një pohim të tillë, ngase i njejtin është bërë pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe është aprovuar nga ana e Gjykatës, pasi që i njejtin është mbështetur në prova të cilat gjenden në shkresat të lëndës, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi në drejtim të pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, pretendohet se dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë të shqiptuara ndaj të akuzuarit janë të larta, e sidomos duke pasur parasysh bashkëpunimin vullnetar të të pandehurit si me rastin e marrjes në pyetje në polici, prokurori dhe Gjykatë, pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, gjendjen e dobët ekonomike, se është i moshës relativisht të re, është i papunë, andaj propozoi që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ulët me burgim dhe me gjobë, e më të cilat dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke patur parasysh pretendimet e cekura ankimore gjeti se ka vend për shqiptimin e një dënimi më të ulët me burgim dhe me gjobë për të akuzuarin e sidomos duke patur parasysh gjendjen e dobët ekonomike të të njejtit, pranimin e fajësisë, sasinë jo të madhe të narkotikut të konfiskuar, andaj i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 100(njëqind) Euro, me bindje se me një dënim të tillë do të realizohet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij dhe të ndikojë edhe në personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.348/18, Më 10.09.2018

Procesmbajtësja
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Have Haliti
